



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 9791 Prot.,

Tiranë, me 02.6.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTERGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mbështetje të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.921, datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

Magaznier, Sektori i Administratës në Degën Doganore Durrës, Kategoria D1 (1 vend)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë pushuar ndonjëherë më parë nga puna për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të kenë arsim të mesëm.
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit;
8. Vendbanimi jo më shumë se 45 km nga vendi i punës

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Përgjigjet materialisht për mallrat dhe paisjet e ndryshme që ka në magazinë si dhe ka përgjegjësi në cdo moment për ruajtjen dhe administrimin e tyre brenda magazinës.
- Kryen të gjitha veprimet e lëvizjes së materialeve në magazinë shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Mban kartelë për gjendjen dhe lëvizjen e cdo artikulli të magazinës.
- Merr në dorëzim mallin duke e parë fizikisht dhe bën magazinimin e tij në kushte optimale.

- Kryen vazhdimisht etiketimin e mallrave në emërtesë dhe çmim dhe bën verifikimin e tyre.
- Bën rakordimin e gjendjes së magazines me shifrat e kontabilitetit të magazinës.
- Mban dhe ndjek analitikisht llogaritë e inventarit në librin e magazines
- Llogarinë 312 Materiale të tjera të stokueshme
- Llogarinë 327 Objekte inventari
- Llogarinë 21 Aktive të qëndryeshme të trupëzuara që përbëhet nga:
 - Paisje të tjera elektronike dhe elektrike
 - Paisje dhe orendi zyrash
 - Paisje radio komunikimi
 - Paisje kompjuterike elektronike
 - Automjetet
- Përbush çdo detyrë tjetër të përcaktuar në akte ligjore, nënligjore, akte të DPD, që i ngarkohen këtij pozicioni pune si dhe përbush detyrat që i ngarkohen nga Kryetari i Doganës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda fushës së detyrave funksionale, në përputhje me ligjin Administron procedurat lidhur me hyrje-daljet e artikujve të ndryshëm në magazinë;
- Kontrollon në mënyrë periodike të gjithë infrastrukturen materiale në Degën Doganor për gjendjen e saj, shkallën e amortizimit, nevojën për riparime, rikonstruksione etj;
- Bashkëpunon me strukturat e Degës Doganore në funksion të përmirësimit të infrastrukturës doganore;
- Përbush çdo detyrë tjetër të përcaktuar në akte ligjore, nënligjore, akte të DPD, që i ngarkohen këtij pozicioni pune si dhe përbush detyrat që i ngarkohen nga Kryetari i Doganës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda fushës së detyrave funksionale, në përputhje me ligjin.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim, e-mail dhe numër telefoni;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomë e shkollës së mesme e noterizuar;
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore/Dëshmi Penaliteti;
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Fotokopje të letërnjoftimit;
10. Fotokopje të librezës së punës;

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Përvojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 12.06.2021, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra e Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

